

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



PRILL

Nënkryetari Bytyqi bëri homazhe te pllaka përkujtimore e Dëshmorit Vezir Kolshi



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, bëri homazhe dhe vendosi një buqetë me lule pranë pllakës përkujtimore të dëshmorit Vezir Kolshi në Baicë, me rastin e 26-vjetorit të rënies së tij.

Ndërsa me një orë letrare u shënua dita e shkollës në Baicë, e cila me krenari mban emrin e dëshmorit "Vezir Kolshi."

Lavdi dëshmorit Vezir Kolshi!

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, bëri homazhe te lapidari i dëshmorit të kombit në qytetin e Lipjanit dhe mori pjesë në përrurimin e bustit të dëshmorit të kombit, Haradin Bajrami, në Magurë, në shenjë respekti për veprën dhe sakrificën e tij për lirinë e Kosovës.



Në qytetin e Lipjanit, bëmë homazhe pranë lapidarit të dëshmorit të kombit, Haradin Bajrami, në shenjë respekti për veprën dhe sakrificën e tij për lirinë e Kosovës.

Pas homazheve, në fshatin Magurë pata nderin të marr pjesë në ceremoninë e zbulimit të bustit të Haradin Bajramit, e cila u organizua në oborrin e shkollës fillore të mesme të ulët që me krenari mban emrin e tij. Vendosija e këtij busti shërben si një kujtesë e përhershme për brezat e sotëm dhe ata që do të vijnë, që të mos harrojnë kurrë sakrificën e atyre që luftuan për lirinë tonë.

Nderimi dhe kujtimi i dëshmorëve nuk është vetëm një akt respekti, por një detyrim ndaj historisë dhe brezave të ardhshëm që të mos harrojnë çmimin e lirisë dhe të frymëzohen për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për vendin tonë.

Më pas vazhduam me homazhe pranë pllakës përkujtimore të dëshmorit Haradin Bajrami në fshatin e lindjes, si dhe pranë varrit të martires Sahadete Dragaçina Bajrami, duke përkujtuar me respekt dhe mirënjohje jetën dhe sakrificën e tyre për Kosovën. Lavdi dëshmorëve të kombit!



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka marrë pjesë në edicionin e dytë të Kuizit të Diturisë i cili u organizua nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Ismail Luma". Ky aktivitet edukativ nxit dijen, mendimin kritik dhe konkurrencën mes nxënësve, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe duke rritur vetëbesimin e tyre për të përballuar sfidat e së ardhmes.



Pata kënaqësinë të marr pjesë në edicionin e dytë të Kuizit të Diturisë, organizuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Ismail Luma".

Ky aktivitet edukativ nxit dijen, mendimin kritik dhe konkurrencën mes nxënësve, duke kontribuar në zhvillimin e aftësive të punës në grup dhe duke rritur vetëbesimin e tyre për të përballuar sfidat e së ardhmes. Urime të gjithëve që morën pjesë – përkushtimi dhe angazhimi juaj janë një frymëzim për të ardhmen!

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë ditës së sotme ka vizituar fillimin e renovimit të shkollës fillore në Janjevë, në kuadër të projektit për rritjen e efikasitetit energjetik



Ka filluar renovimi i shkollës fillore në Janjevë, në kuadër të projektit për rritjen e efikasitetit energjetik.

Përmes këtij investimi synojmë të krijojmë një objekt më efikas, me kushte më të mira dhe ambiente më të përshtatshme për nxënësit dhe stafin arsimor. Ndërkohë Janjeva, së shpejti do të përfitojë edhe rrjetin e ri të energjisë elektrike, si dhe ndriçimi publik do të rinovohet tërësisht.

Besojmë se përmes investimeve të vazhdueshme në infrastrukturë, po ndërtojmë një ambient më të mirë, më funksional dhe më të denjë për të gjithë qytetarët e Janjevës.



Nënkryetari Bytyqi nderon dëshmorin Ramiz Shala në përvjetorin e rënies



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule te varri i dëshmorit Ramiz Shala, në kompleksin memorial të Brigadës 121 “Kumanova” në Kleçkë, si dhe te pllaka përkujtimore në Resinovc, në nderim të jetës dhe veprës së tij, me rastin e 26-vjetorit të rënies.

Me këtë rast nënkryetari Bytyqi theksoi se kujtimi për dëshmorët është përjetësisht i gjallë, sakrificat e tyre është themeli mbi të cilin ndërtojmë të ardhmen tonë. Lavdi!

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka vizituar përfundimin e punimeve në rrugën “Hivzi Sylejmani” në fshatin Dobrajë e Madhe, projekt ky që shënon një tjetër hap në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës lokale.



Kryetari Ahmeti ka uruar qytetarët e Dobrajës së Madhe për këtë investim, duke theksuar se angazhimi i Komunës për përmirësimin e infrastrukturës do të vazhdojë edhe më tutje. “Rruga e re është e pajisur me trotuarë, ndriçim publik, kanal dhe mbrojtëse të kanalit, duke e bërë atë një segment modern dhe funksional për qytetarët. Ky investim është realizuar tërësisht nga buxheti i Komunës së Lipjanit”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti. Ai gjithashtu bëri të ditur se gjatë këtij viti do të vazhdohet me realizimin e projekteve të tjera infrastrukturore, përfshirë ndërtimin e rrugës nga Poturovci deri në Ribar të Madh dhe segmentin nga Dobratini deri në Sllovi, duke theksuar se në këto zona do të aplikohet i njëjti model i rrugës, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët e komunës.

Ka filluar projekti për izolimin e objektit të banimit social në Magurë



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka vizituar nga afër punimet për izolimin e objektit të banimit social në Magurë, një projekt që ka për qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për banorët që jetojnë aty.

“Punimet janë duke u realizuar me standarde të larta, që do t’u mundësojnë banorëve kushte më të mira jetese, më pak shpenzime për ngrohje gjatë dimrit dhe më shumë freski gjatë verës,” tha Kryetari Ahmeti.

Ai theksoi se angazhimi i Komunës së Lipjanit për të siguruar një jetë më të mirë për çdo qytetar mbetet një prioritet i pandryshuar.

Kryetari Ahmeti nderon me homazhe dëshmorët dhe martirët e Sllovisë dhe Akllapit



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë pllakave përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve të fshatrave Sllovi dhe Akllap, në shenjë nderimi dhe respekti për sakrificën e tyre në rrugën drejt lirisë.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se kujtimi dhe nderimi për dëshmorët dhe martirët përbën një detyrë të përhershme për institucionet dhe qytetarët, pasi liria që e gëzojmë sot është ndërtuar mbi sakrificën e tyre sublime. “Emrat dhe sakrifica e tyre janë të gdhendur përgjithmonë në kujtesën tonë kolektive dhe përbëjnë themelin e lirisë që e jetojmë sot,” tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve dhe martirëve të kombit!

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule te varri i dëshmores Zylfije Gashi dhe te varri i luftëtarit të lirisë, Agron Gashi, në fshatin Tërbovc.



Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se kujtimi për ta nuk është thjesht një ceremoni, por një kujtesë e përditshme se gjaku i tyre është themeli mbi të cilin u ndërtua liria jonë.

“Ata ranë që ne të jetojmë të lirë dhe kjo liri mbetet amaneti më i shenjtë që na obligon të punojmë me përkushtim, drejtësi dhe dinjitet,” tha Kryetari Ahmeti. Lavdi e përjetshme dëshmorëve të lirisë!

Mbahet takimi i parë i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2025



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), i kryesuar nga Nënkyetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, mbajti takimin e parë të rregullt për vitin 2025. Gjatë këtij takimi u diskutua gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Lipjanit, pastaj u prezantua raporti i punës së KKSB-së për vitin 2024, si dhe u shqyrtua plani i punës së KKSB-së për vitin 2025.

Anëtarët e KKSB-së theksuan rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe bënë thirrje për një angazhim më të madh të qytetarëve në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, me qëllim përmirësimin e sigurisë në komunitet.

Kryetari Ahmeti viziton fermerët në fshatin Sllavi



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, vizitoi fermëren znj. Valbona Rama Sopa si dhe fermerin z. Osman Kryeziu të cilët merren me kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore në sera.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se fermerët japin një kontribut të rëndësishëm në prodhimin vendor. “Fermerët përbëjnë shtyllën kryesore të zhvillimit rural dhe mbështetja ndaj tyre mbetet një nga prioritetet kryesore të komunës”, tha kryetari z. Imri Ahmeti. Gjatë vizitës, ai inspektoi edhe rrugën e re të shtruar me zhavorr e cila lehtëson qasjen në tokat bujqësore dhe transportin e prodhimeve dhe njëkohësisht ka lidhur dy rrugët kryesore të fshatit.

Kryesuesi Azemi nderoi me homazhe martirin Xhevat Rexhepi



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Lipjanit, z. Daut Azemi, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, sot ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë pllakës përkujtimore të martirit Xhevat Rexhepi, me rastin e 26-vjetorit të rënies së tij.

Me këtë rast, Kryesuesi Azemi theksoi se kujtimi për martirët e kombit do të mbetet gjithmonë i gjallë në ndërgjegjen tonë kolektive.

Lavdi të gjithë martirëve!

Kryetari Ahmeti mirëpret zëvendëskomandantin e KFOR-it amerikan



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në një takim zyrtar Zëvendëskomandantin e KFOR-it amerikan nga Komanda Rajonale – Lindje, Nënkolonelin Evan Hessel, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij dhe përfaqësues të KFOR-it Turk të udhëhequr nga Kadir Ozturk, të vendosur në Lipjan.

Në qendër të diskutimit ishte situata e sigurisë në Komunën e Lipjanit dhe zhvillimet aktuale në vend.

Kryetari Ahmeti, gjatë takimit, ka folur gjithashtu për komunitetet jo shumicë që jetojnë në Komunën e Lipjanit dhe për rëndësinë e KFOR-it, si dhe për stabilitetin që ata ofrojnë për qytetarët e Komunës së Lipjanit.

Nga ana e tij, Nënkoloneli Hessel vlerësoi lart përparimin e Komunës së Lipjanit në të gjitha fushat, duke përfshirë edhe atë të sigurisë. Ai shprehu përkushtimin për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me komunën, jo vetëm në aspektin e sigurisë, por edhe në fusha të tjera që kanë rëndësi për mirëqenien e qytetarëve.

Në shenjë mirënjohjeje dhe respekti, kryetari Ahmeti i dhuroi nënkolonelit Hessel stemën e Komunës së Lipjanit, ndërsa ky i fundit i dorëzoi kryetarit emblemën e Brigadës së 41-të të Këmbësorisë në Amerikë, si simbol i respektit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë.



Kryetari Ahmeti nderon me homazhe dëshmorët dhe martirët e Ribarit të Vogël, Blinajës dhe Kraishtës



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë pllakave përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve të fshatrave Ribar i Vogël, Blinajë dhe Kraishtë, në shenjë nderimi dhe respekti për sakrificën e tyre në rrugën drejt lirisë.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se sakrifica e dëshmorëve dhe martirëve është themeli mbi të cilin është ndërtuar shteti ynë. “Liria që gëzojmë sot nuk është dhuratë, është rezultat i gjakut të derdhur dhe i qëndresës për çlirim. Prandaj, është detyrë e jona t’i kujtojmë gjithmonë me nderim dhe mirënjohje të thellë. Nderimi për ta është respekt për vetë lirinë dhe ekzistencën tonë si popull dhe si shtet,” tha kryetari Ahmeti.

Ai theksoi se nderimi më i madh që mund t’u bëhet dëshmorëve dhe martirëve është të punojmë me përkushtim, ndershmëri dhe përgjegjësi për zhvillimin e vendit tonë.

Lavdi e përjetshme dëshmorëve dhe martirëve të lirisë!

Kryetari Ahmeti nderon me homazhe dëshmorët dhe martirët e Hallaqit të Vogël dhe Rufcit të Ri



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqeta me lule pranë pllakave përkujtimore të dëshmorëve dhe martirëve të fshatrave Hallaqi i Vogël dhe Rufci i Ri.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se përkulemi me nderim dhe mirënjohje para varrezave të dëshmorëve dhe martirëve, në shenjë respekti për sakrificën e tyre për lirinë e atdheut.

“Ata dhanë gjithçka për lirinë tonë, ne kemi për obligim të nderojmë sakrificën e tyre çdo ditë, me punë, drejtësi dhe përkushtim ndaj Kosovës,” tha kryetari Ahmeti. Lavdi e përjetshme dëshmorëve dhe martirëve të kombit!



Mbahet Akademi Përkujtimore në nderim të 26-vjetorit të rënies së dëshmorëve dhe martirëve të Komunës së Lipjanit



Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, në fjalën e tij të rastit theksoi se muaji prill mbetet një plagë e hapur në kujtesën kolektive, por njëkohësisht edhe burim krenarie dhe përkushtimi.

“Prilli nuk është thjesht një muaj kalendari, është plagë që nuk mbyllet kurrë, kujtim që dhemb, por edhe na jep forcë. Është amanet që e mbajmë me krenari”, tha kryetari Ahmeti.

Ai përkujtoi mizoritë e kryera në fshatra si Sllovi, Ribar i Vogël, Hallaq e shumë fshatra të tjera, ku qytetarë të pafajshëm u vranë vetëm pse ishin shqiptarë.

“Kujtimi për ta nuk është ceremoni, por zotim – zotim se nuk do t’i harrojmë dhe se nuk do ta shkelim kurrë gjakun e tyre. Gjaku i tyre është vetë liria jonë, dhe kjo liri na detyron të jemi të ndershëm, të drejtë dhe të përkushtuar për një Kosovë që e meriton amanetin e tyre”, tha Kryetari Ahmeti.

Kryetari Ahmeti bëri thirrje për reflektim, përkujtim dhe angazhim të përditshëm ndaj amanetit të dëshmorëve – për shtet, barazi dhe drejtësi. Në këtë akademi, me fjalë rasti morën pjesë edhe përfaqësues të familjeve të dëshmorëve dhe martirëve, Ukfir Jashari dhe Qëndrim Gashi, të cilët me fjalët e tyre shtuan peshën e këtij kujtimi të përbashkët.

Akademia u përmbyll me një monolog prekës nga nxënësjja Tara Rexhepi, e cila përmes fjalës artistike, përçoi emocione të forta dhe nderoi kujtimin e të rënëve.

Lavdi e përgjeshme dëshmorëve dhe martirëve të kombit!

KPF mban mbledhjen e 36-të me radhë



Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), udhëhequr nga Kryesuesi i Kuvendit z. Daut Azemi, ka mbajtur mbledhjen e 36-të me radhë, ku janë diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës të propozuara për këtë mbledhje. Me këtë rast, Kryesuesi i Kuvendit, z. Daut Azemi, përveç pikave të propozuara për këtë mbledhje, ka prezantuar edhe një pikë shtesë për diskutim në këtë mbledhje. Anëtarët e KPF-së pas diskutimeve, kanë rekomanduar të gjitha pikat për shqyrtim dhe aprovim në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit të Komunës, e cila do të mbahet të enjten, më 24 prill 2025.

Kryetari Ahmeti mirëpret kampionët e volejbollit të Gjimnazit “Ulpiana”



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim nxënësit e Gjimnazit “Ulpiana”, bashkë me mësimdhënësit dhe drejtorin e shkollës, të cilët kanë fituar vendin e parë në garat republikane në volejboll, të organizuara nga Federata e Sportit Shkollor të Republikës së Kosovës.

Kryetari Ahmeti vlerësoi lartë arritje e të rinjve lipjanas, duke theksuar përkushtimin, talentin dhe shpirtin e tyre garues të dëshmuar në garat e volejbollit.

“Ky sukses është pasqyrë e përkushtimit, punës së palodhshme dhe shpirtit garues që e karakterizon rininë tonë . Një arritje që na bën të gjithëve krenarë dhe dëshmon se Lipjani është vend i të rinjve të talentuar, të disiplinuar dhe të vendosur drejt suksesit,” tha kryetari Ahmeti.

Ai shprehu krenarinë për këtë arritje të jashtëzakonshme të nxënësve, duke i uruar për suksesin dhe duke i cilësuar si model frymëzimi për gjeneratat e ardhshme.

U mbajt mbledhja e 41-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit



Kuvendi i Komunës së Lipjanit, udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 41-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan të gjitha pikat e rendit të ditës, të cilat ishin propozuar për këtë seancë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

Fillohet trajnimi për gratë në fushën e hortikulturës në Komunën e Lipjanit



Në Komunën e Lipjanit, ka filluar trajnimi për gratë në fushën e hortikulturës, në kuadër të projektit “Mundësitë e përmirësuara të vetëpunësimit dhe punësimit”, që po realizohet në bashkëpunim me organizatën Kosova - Women 4 Women.

Ky projekt u bë i mundur pas nënshkrimit të memorandumit të mirëkuptimit nga Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, me qëllim fuqizimin ekonomik të grave, veçanërisht atyre të marginalizuara.

Gjatë hapjes së trajnimit, Drejtori për Ekonomi dhe Zhvillim, z. Valon Pacolli, theksoi se përkrahja me pajisje pune dhe trajnime ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e ndërmarrësisë dhe fuqizimin e gruas. Ai shtoi se kjo përbën një mision të vazhdueshëm të nivelit lokal, pasi gruaja lipjanase konsiderohet si një shtyllë e fortë e zhvillimit ekonomik të komunës sonë.

Ky trajnim përfaqëson një hap konkret drejt rritjes së mundësive për punësim dhe vetëpunësim të grave, duke synuar përmirësimin e pozitës së tyre në tregun e punës dhe në ekonomi. Projekti mbështetet nga Komuna e Lipjanit dhe Agjencia Austriake për Zhvillim.

Kryetari Ahmeti nderon me homazhe dëshmorin Shaqir Hoxha në përvjetorin e rënies



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule te varri i dëshmorit Shaqir Hoxha, në kompleksin memorial të Brigadës 121 “Kumanova” në Kleçkë, si dhe te pllaka përkujtimore në Nekovc, në nderim të jetës dhe veprës së tij, me rastin e 26-vjetorit të rënies. Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se dëshmorët janë themeli mbi të cilin është ndërtuar liria dhe shteti ynë. Sakrificat e tyre sublime na obligon që me përkushtim të palëkundur, përgjegjësi të lartë dhe vizion të qartë, ta vazhdojmë rrugën drejt ndërtimit të një vendi më të zhvilluar, më të drejtë dhe më dinjitoz. Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!

Nënkryetari Bytyqi nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Islamic Relief Kosova



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me organizatën Islamic Relief Kosova, në kuadër të projektit “Projekt i integruar për mbështetje në Shëndetësi, Arsim dhe Ekonomi Rurale në Kosovë”.

Me këtë rast, Nënkryetari Bytyqi theksoi se kjo marrëveshje përbën një hap konkret drejt fuqizimit ekonomik të qytetarëve, duke krijuar mundësi të reja për zhvillim dhe vetëpunësim në Komunën e Lipjanit.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, do të ndahen grante për start-up biznese në territorin e Komunës së Lipjanit, duke ofruar mundësi të reja për punësim dhe vetëpunësim për banorët lokalë.

Ky projekt, i mbështetur nga Islamic Relief Deutschland, synon të nxisë zhvillimin ekonomik lokal përmes mbështetjes së iniciativave të reja afariste.

Komiteti për Komunitete ka zhvilluar punimet e mbledhjes së 37-të me radhë



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, u mbajt mbledhja e 37-të e Komitetit për Komunitete (KK), e udhëhequr nga kryesuesi, z. Skender Bikliqi, ku u shqyrtuan të gjitha pikat e rendit të ditës.

Gjatë këtij takimi, Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, z. Shkelzen Hajdini, informoi anëtarët e KK-së lidhur me qasjen e komuniteteve në shëndetësi, ndërsa përfaqësuesit e Zyrës Lokale për Komunitete informuan të pranishmit lidhur me raportin e punës së ZKKK-së.

Në përfundim të mbledhjes, anëtarët e Komitetit shqyrtuan disa çështje të ndryshme që prekin jetën e qytetarëve të Komunës së Lipjanit.

Mbahet takimi i radhës i Këshillit Publiko-Privat në Lipjan



Në sallën e takimeve të Komunës së Lipjanit, është mbajtur takimi i radhës i Këshillit Publiko-Privat, i organizuar nga kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti.

Në hapje të takimit, kryetari Ahmeti falënderoi përfaqësuesit e bizneseve dhe të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës, duke çmuar bashkëpunimin e deritanishëm dhe pjesëmarrjen e tyre aktive. Ai theksoi se këto takime luajnë një rol kyç në ndërtimin e një marrëdhënieje të qëndrueshme ndërmjet komunës dhe sektorit privat, duke ofruar një hapësirë të nevojshme për identifikimin dhe adresimin e sfidave të përditshme me të cilat përballen bizneset.



“Ky takim është dëshmi konkrete e angazhimit tonë për të dëgjuar zërin e përfaqësuesve të bizneseve dhe për të bashkërenduar veprimet që kontribuojnë në përmirësimin e klimës së të bërit biznes në Lipjan. Ne mbetemi të përkushtuar që, përmes një dialogu të hapur dhe të qëndrueshëm, të ndërtojmë politika zhvillimore që u përgjigjen drejtpërdrejt kërkesave dhe nevojave të sektorit privat”, tha kryetari z. Imri Ahmeti. Ai shtoi se Komuna e Lipjanit nuk aplikon asnjë lloj takse për bizneset që veprojnë në territorin e saj, ndërsa paralajmëroi se gjatë këtij viti do të nisin edhe diskutimet publike për Hartën Zonale, një dokument strategjik që do të ndikojë ndjeshëm në planifikimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të komunës.

Përfaqësuesit e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë së Kosovës e mirëpritën iniciativën e Komunës së Lipjanit për të krijuar ura komunikimi me bizneset lokale, duke theksuar se bashkëpunimi i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve dhe sektorit privat është kyç për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në nivel lokal.

Anëtarët e Këshillit Publiko-Privat falënderuan kryetarin Ahmeti, duke vlerësuar rëndësinë e këtyre takimeve si një mundësi të vlefshme për shkëmbim mendimesh, trajtim të sfidave dhe nxitje të bashkëpunimit konkret, me synim përmirësimin e klimës investuese dhe avancimin e zhvillimit ekonomik në komunë.

Këshilli Publiko-Privat funksionon si një mekanizëm këshillues për forcimin e dialogut ndërmjet institucioneve komunale dhe sektorit privat në Komunën e Lipjanit.

Mbahen garat tradicionale të ndihmës së parë në Lipjan



Kryqi i Kuq i Kosovës, dega në Lipjan, organizoi garat tradicionale të ndihmës së parë në sheshin "Adem Jashari", me pjesëmarrjen e nxënësve të gjimnazit "Ulpiana" në Lipjan, paraleles së ndarë në Gadime, si dhe të shkollës profesionale "Adem Gllavica".

Me këtë rast, Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, përgëzoi të rinjtë për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre në gara të këtij lloji.

"Këto gara kanë një rëndësi të veçantë, sepse i ndihmojnë të rinjtë të jenë të përgatitur për të reaguar shpejt dhe me efikasitet në situata të vështira dhe emergjente, ku shpesh varet edhe jeta e njerëzve", tha kryetari Ahmeti.

Aktivitete të tilla kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe zhvillimin e aftësive praktike të të rinjve në fushën e ndihmës së parë, duke i pajisur ata me njohuri të vlefshme për jetën.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka pritur në takim përfaqësueset e Rrjetit të Grave të Kosovës, me të cilat ka bashkëbiseduar mbi mundësinë e bashkëpunimit institucional në kuadër të iniciativës “Forcimi i kapaciteteve dhe mekanizmave për të adresuar dhunën në baza gjinore”.



Në këtë rast, Nënkryetari Bytyqi theksoi se Komuna e Lipjanit është e përkushtuar të mbështesë çdo iniciativë që ka për qëllim forcimin e mekanizmave të koordinuar komunalë kundër dhunës në familje.

Kjo iniciativë synon të përforcojë Mekanizmin Koordinues Komunal Kundër Dhunës në Familje (MKKDhF), përmes vlerësimit të nevojave konkrete në terren dhe ofrimit të trajnimeve për institucionet përkatëse.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar në ndërtimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe me barazi për të gjithë qytetarët, duke mbështetur çdo iniciativë që fuqizon reagimin institucional ndaj dhunës në baza gjinore.

Kryetari Ahmeti viziton vendosjen e 100 serave të reja në Komunën e Lipjanit



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka vizituar nga afër procesin e vendosjes së 100 serave të reja, me qëllim të mbështetjes së bujqëve në Komunën e Lipjanit.

Me këtë rast, Kryetari Ahmeti bëri të ditur se ka përfunduar me sukses montimi i 100 serave, ndërsa së shpejti pritet të nisë edhe montimi i 95 serave të tjera, si pjesë e mbështetjes së vazhdueshme për sektorin e bujqësisë.

“Gjatë viteve të fundit, janë shpërndarë gjithsej 1,100 sera për familjet që merren me kultivimin e bimëve të ndryshme, duke ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e ekonomisë familjare dhe në zhvillimin e bujqësisë lokale”, tha Kryetari Ahmeti.

Ai shtoi gjithashtu se deri më tani janë shpërndarë rreth 1,425 mjete bujqësore, përfshirë motokultivatorë, freza, spërkatës dhe shpërndarës të plehut mineral, ndërsa gjatë këtij viti pritet të shpërndahen edhe 338 mjete të tjera bujqësore, në funksion të mbështetjes së mëtejshme për fermerët e komunës.

Prezantohet studimi i fizibilitetit për sistemin e ngrohjes qendrore të qytetit të Lipjanit




Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim përfaqësuesit e organizatës holandeze CNVP, të cilët prezantuan studimin e fizibilitetit për projektin e ngrohjes qendrore në qytetin e Lipjanit.

Kryetari Ahmeti vlerësoi lart rëndësinë e këtij projekti, duke theksuar se zgjidhja e problemit të ngrohjes është një ndër prioritetet e Komunës dhe se një projekt i tillë, jo vetëm që adreson një nevojë të përditshme, por edhe do të ndikonte ndjeshëm në përmirësimin e cilësisë së jetës në qytet. Ai gjithashtu falënderoi organizatën CNVP për mbështetjen e vazhdueshme dhe përkushtimin e tyre profesional.

Gjatë takimit u prezantuan analizat dhe gjetjet e para të këtij studimi nga një kompani austriake eksperte, e cila është e angazhuar në fazën e parë të projektit. Studimi trajton mundësitë reale për realizimin e një sistemi modern të ngrohjes qendrore, si një zgjidhje afatgjatë për problemin e furnizimit me ngrohje në qytet.

Ky është vetëm hapi i parë, bëhet fjalë për studimin e fizibilitetit për sistemin e ngrohjes qendrore në qytetin tonë. Projekte të tilla konsiderohen të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për përmbylljen e infrastrukturës së nevojshme për ngrohjen e qytetit të Lipjanit.





Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508